



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 paragrafit 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/2019) dhe nenit 40 dhe nenit 41 të Rregullores së punës së shtetit. Komisioni për Parandalimin e Korrupsionit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: KSHPK) në seancën e 75-të të mbajtur më 14.10.2022 ka miratuar

Vendim

Procedura për lëndën me nr. 08-4320/1 datë 30.10.2021, NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave, nuk ka elemente për veprim të mëtejshëm nga KSHPK-ja sipas lëndës me numër 08-4320/1 të datës 30.10.2021.

Lënda me numër 08-4320/1 datës 30.10.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 08-4320/1 të datës 30.10.2021 është formuar me vetiniciativë.

Nga mbikëqyrja e evidencave të saj, KSHPK-ja konstatoi se personi _____ nuk ka dorëzuar flet anketuese në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në afatin e paraparë me ligj prej 30 ditësh pas zgjedhjes për anëtar të Bordit -----
-----.

KSHPK-ja përpiloj raport për kundërvajtjen dhe urdhërpagesën e konstatuar ia dorëzoi personit _____. Më datë 16.06.2022 e ka paguar gjobën në shumën e shënuar në urdhërpagesë për kundërvajtje.

KSHPK, pas shqyrtimit të lëndës, konstaton se nuk ka elemente për veprimin e saj të mëtejshëm kompetent në rastin konkret.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. Nikolina Tarçullovaska-Miloshevaska, këshilltare
Miratoi: Nuri Bajrami, anëtar

КОМИСИОНИ СХТЕТЌОРОР
ПЉР PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
КРЈЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska

